

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri si dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.F.1, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1047-3/13 të datës 03.03.2013, pas mbajtjes së shqyrtimeve të hapura gjyqësor me datë 08.06.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: A.F.1, nga fsh..... komuna Ferizaj, data e lindjes....., nga i ati G. dhe e ëma E., e gjinisë K., i martuar, prind i pesë fëmijëve, i pa punë, i gjendjës së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 21.05.2013, në fshatin Pleshinë komuna Ferizaj, i pandehuri ka dëmtuar rrethojat-telin të cilin e ka vendosur i dëmtuari I.F.1 për ta kufizuar pronën e tij në rrugë në atë mënyrë që ka ndezur një zjarr rreth pronës së të dëmtuarit duke djegur disa shkurre dhe thasë letre dhe nga kjo djegie janë dëmtuar shtyllat e metalta dhe teli i rrethojës duke i shkaktuar dëm të dëmtuarit,

- me të cilën kreu veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 42, 46 dhe 75 të KPK-së si dhe nenit 495, të KPP, të pandehurin, e

G J Y K O N

Me dënim në gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në forma të tjera sipas nenit 46 të KPK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burg.

I dëmtuari I.F.1 nga fsh..... komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.1047-3/13 të dt03.03.2014 e ka ngarkuar të pandehurit A.F.1 për veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor, në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, ndërsa pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor konform nenit 350 të KPP-së prokurori i shtetit Ismet Rrahmani ka bërë rikualifikimin e veprës penale në veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, ndërsa në fjalën përfundimtare mbeti në tërësi pranë aktit akuzues dhe rikualifikimit juridik të tij, duke kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe ti përcaktohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Të akuzuarit A.F.1 konform nenit 325 të KPPK-së në shqyrtimin gjyqësor i është dhënë mundësia për tu deklaruar lidhur me fajësinë, ku i njëjti ka deklaruar se nuk ka bërë asnjë uzurpim të pronës së askujt e as të dëmtuarit I.F.1. Në vitin 2000-2001 unë me kushërinjtë Q.F., A.F.2, I.F.1, J.F., Xh.F., M.F. dhe B.F. në shtëpinë e B.F.t kemi bërë një marrëveshje që secili nga prona e tij ti lirojë nga 2.25metra në mënyrë që ta bëjmë një rrugë të re të përbashkët, të cilën rrugë më vonë e kemi shtruar me zhavorr dhe disa me kubëza, ndërsa unë diku në vitin 2013 pjesën e rrugës deri sa kufizohet me pronën time e kam shtruar me asfalt të bluar. I njëjti ka shtuar se prona e I.F.1t është përball shtëpisë së tij dhe rrugën e kanë në mes ku secili ka lëshuar nga 2.25 metra, dhe deri sa i pandehuri e ka shtruar rrugën me asfalt të bluar pasi që rruga ka qenë me baltë dhe se për këtë nuk e ka pyetur të dëmtuarin I.F.1 sepse e ka shtruar për nevoja të tija dhe se gjatë shtruarjes së rrugës i dëmtuari nuk i ka thënë asgjë se pse po e shtron rrugën e as asgjë. I pandehuri ka vazhduar mbrojtjen e tij duke deklaruar se problemi ka filluar me rastin kur punëtorit të cilët ishin duke e punuar në shtëpinë e tij kanë ndezur thasët e të çimentos afër rrethojës së të dëmtuarit dhe për këtë i dëmtuari kishte lajmëruar rastin në polici dhe për këtë çështje ka dhënë edhe deklaratë.

Gjykata pas administrimit të provave të propozuara nga prokurori i shtetit, i dëmtuari si dhe i pandehuri në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimin të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari I.F.1 në dëshminë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se i ka dhënë një deklaratë edhe në prokurori e edhe në polici dhe këtyre ju përmbahem në tërësi duke shtuar se me dt.21.05.2013 e ka vërejtur se i pandehuri e kishte dëmtuar rrethojën duke djegur mbeturina, shkurre, dërrasa të materialit ndërtimor. I njëjti ka vazhduar me dëshminë e tij duke deklaruar se në vitin 2000 kanë pasur marrëveshje interne ku prezent kanë qenë I.F.2, M.F., B.F., i akuzuari A.F.1, J.F. e Xh.F. të cilët së bashku secili nga personat e lartpërmendur në baza vullnetare dhe pa kompensim pasi që jemi kushëri mes vete nga prona e tyre i kanë lëshuar nga 2.25 metra për ta krijuar një rrugë të re të gjerë 4.50 me që jemi kushëri mes veti, të cilën marrëveshje e ka përpiluar me shkrim Xh.F. dhe të gjithë e kemi nënshkruar mirëpo nuk e di se ku ka mbetur ajo marrëveshje. Mirëpo pasi që në vitin 2009 kemi pasur një kontest mes veti, e kam njoftuar të pandehurin personalisht se kjo marrëveshje më nuk ekziston dhe nuk ka rrugë të përbashkët dhe i pandehuri edhe pse në vitin 2013 ka qenë i njoftuar se më rrugë të përbashkët nuk kemi i njëjti ka vazhduar dhe ka shtruar komplet rrugën me zhavorr pa më pyetur mua. Gjykata e ka vlerësuar dhe analizuar dëshminë e të dëmtuarit të njëjtën e merr si të pjesërisht të bazuar sa i përket deklaramit të tije

se i pandehuri i ka dëmtuar rrethojën duke ndezur zjarr, mbeturina, shkurre, dërrasa të materialit ndërtimor, nga se e njëjta bazohet edhe në dëshmitë dhe provat tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Dëshmitari Q.F. në dëshminë e dhëne në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk është në dijeni nëse i pandehuri ka uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme ndonjë pronë të ndokujt, duke shtuar se kushërinjtë mes vete babai im, A.F.1, A.F.2, M. F., J.F., Xh.F. si dhe I.F.1 kemi pasur marrëveshje diku në vitin 2000 që secili me i liruar përafërsisht nga 2 metra nga pjesa e tokës së tyre në mënyrë që ta bëjmë një rrugë të përbashkët dhe këtë rrugë e cila është e gjatë afër 300 metra është shtruar me zhavorr dhe disa pjesë me kubëza. Të njëjtën rrugë e shfrytëzojmë edhe tani dhe mua nuk më ka njoftuar askush që mos ta shfrytëzoj me këtë rrugë, nuk me ka thënë askush e as i dëmtuari I.F.1 se më marrëveshje nuk kemi për këtë rrugë. Dëshmitari ka vazhduar duke deklaruar se ka parë në rrugë duke u djegur disa qese dhe disa thasë të çimentos.

Dëshmitari E.J.F. në dëshminë e dhëne në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se unë nuk jam i njoftuar se i pandehuri ka bërë uzurpim të ndonjë prone. Diku në vitin 2000 kemi pasur marrëveshje mes vete kushërinjtë I.F.1, J.F., Xh.F., Q.F., A.F.2, A.F.1 e M.F. dhe jemi marr vesh mes veti që ti lëshojmë nga pronat tona nga 2.25 metra secili që të krijojmë rrugë të re, kjo marrëveshje ka qenë me shkrim por të njëjtën nuk e kemi ruajtur. Të njëjtën rrugë e shfrytëzojmë në mënyrë të përbashkët. I njëjti ka deklaruar se viti nuk me kujtohet por ka qenë policia dhe në atë moment e kam parë I.F.1in pasi që ishin kallë disa thasë të letrave të bërrilokut të cilat ishin në rrugë. Dëshmitari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk ka qenë i njoftuar në vitin 2009 se është prishur marrëveshja dhe se asnjëherë nuk jemi mbledhur kushërinjtë me të cilët kemi pasur marrëveshje për krijimin e kësaj rruge që të bisedojmë më lidhur me këtë rrugë, duke shtuar se në këtë rrugë tani janë ndërtuar gjithsej tetë shtëpi dhe vazhdojnë ta shfrytëzojmë këtë rrugë pa u penguar nga askush.

Dëshmitari Xh.F. në dëshminë e dhëne në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se unë nuk është në dijeni se i pandehuri ka bërë uzurpim të ndonjë prone të ndokujt, por e di që menjëherë pas lufte viti saktë nuk më kujtohet kushërinjtë mes vete I.F.1i, Q.F., A.F.1, M.F., A.F.2, B.F., unë Xh.F. e J.F. jemi mbledhur ku të gjithë në mënyrë vullnetare pa presion kemi arritur marrëveshje që secili nga prona e tij të liron nga 2.25 metra për shfrytëzimin e rrugës së përbashkët, për të cilën e kemi pasur edhe një procesverbal por nuk po mundemi ta gjejmë. Të njëjtën rrugë vazhdojmë ende ta shfrytëzojmë nga banorët e asaj rruge dhe se pas kësaj marrëveshje më nuk jemi mbledhur kushërinjtë që të bisedojmë lidhur me prishjen e kësaj marrëveshje.

Dëshmitari M.F. në dëshminë e dhëne në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se unë nuk është në dijeni se i pandehuri ka bërë uzurpim të ndonjë prone diku, por e di që në vitin 2000-2001 kanë bërë marrëveshje për krijimin e rrugës së re ku pjesë e marrëveshjes kanë qenë unë M.F., I.F.1, A.F.1, Q.F., A.F.2, Xh.F. e J.F. që në të dy anët e rrugës secili nga prona e vetë ti liroj nga 2.25 metra për krijimin e rrugës së re e cila rrugë vazhdon të shfrytëzohet edhe sot, të cilën marrëveshje e kemi nënshkruar por tani nuk e si se ku është ajo marrëveshje. Dëshmitari ka deklaruar se nuk e di nëse i dëmtuari I.F.1 e ka njoftuar A.F.1n në vitin 2009 se më nuk kanë rrugë të përbashkët.

Dëshmitari A.F.2 në dëshminë e dhëne në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se unë nuk jam i njoftuar se i pandehuri ka bërë uzurpim të ndonjë prone, por e di që kushërinjtë mes vete, ai, I.F.1, Xh.F., J.F., M.F. e A.F.1 kanë pasur marrëveshje mes vete me shkrim por nuk e din se ku gjendet më ajo marrëveshje dhe jemi mare vesh gojarisht sipas traditave që secili

nga prona e tij ti lirojë nga 2.25 metra dhe pasi që është bërë kjo marrëveshje për këtë rrugë të njëjtën e kemi shtruar me zhavorr dhe një pjesë me kocka të cilën rrugë e shfrytëzojmë edhe sot. Dëshmitari ka deklaruar se nuk është ndezur asgjë në pronën e I.F.1, por i ka parë policinë në rrugë kinse janë ndezur disa mbeturina në rrugë përballë shtëpisë së I.F.1, duke shtuar se nuk është i informuar as në vitin 2009 e as në vitin 2012 se rrugë të përbashkët më nuk kemi, nuk komunikojmë mes vete.

Dëshmitari H.R. në dëshminë e dhëna në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se lidhur me rastin ka përpiluar raport me shkrim të cilën e ka nënshkruar, duke shtuar se koha e saktë nuk i kujtohet, dhe se pas marrjes së informatës nga baza kemi shkuar në vendin e ngjarjes në fshatin Pleshinë kemi kontaktuar me ankuesin ku bëhet fjalë për dëmtim prone. Në vend të ngjarjes kishte qenë i ndezur një zjarr dhe ishte dëmtuar rrethoja i cili ishte i ndezur afër rrethojave e cila ishte e dëmtuar. Nuk i kujtohet nëse i kanë sugjeruar të pandehurit që ta tërheq zhavorrin nga rruga dhe nuk e din se çka ka thënë i pandehuri por e di që i ka thënë se është i gatshëm që t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar të dëmtuarit dëmtimin e rrethojës.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka bërë administrimin e provave materiale dhe atë certifikatën mbi të drejtat e paluajtshme nr.UL-72217068-00120 dt.06.07.2013, kopja e planit nr.5/55, fotografit dhe deklarata e të dëmtuarit I.F.1, nga të cilat gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarëve Q.F., J.F., Xh.F., M.F. e A.F.2 si dhe dëshmitarit H.R. të dhëna në shqyrtimin gjyqësor dhe dëshminë e këtyre dëshmitarëve dhe nga fakti se dëshmitë e tyre pothuajse janë identike, objektive dhe reale dhe mbështeten në provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç është deklarimi i vetë të dëmtuarit, e po ashtu pjesërisht edhe vetë i pandehuri.

Gjykata e mori në konsideratë edhe mbrojtjen e të akuzuarit, i cili pjesërisht e ka pranuar kryerjen e veprës penale, mirëpo gjykata një mbrojtjes së tillë nuk ia fali besimin, sepse mbrojtja e të pandehurit është kontradiktore, nuk është e mbështetur në prova dhe fakte, por më shumë është e orientuar nga fshehja e veprimeve inkriminuese me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nen.73 të KPK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh faktin se nuk ka të dhëna se i akuzuari më parë ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, se është i martuar dhe baba i pesë fëmijëve, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe dëmin e shkaktuar ku është dëmtuar vetëm një pjesë e rrethojës – telit, e në mungesë të rrethanave rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rezikshmerinë konkrete të veprës penale conform nenit 75 dhe 76 bëri zbutjen e dënimit duke i shqiptuar të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale me bindje se me këtë lloj të dënimit, do të arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPK-së.

I dëmtuari I.F.1 nga fsh..... komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore –juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 450 të KPPK-së, gjykata të akuzuarin e obligoi që në paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/€, në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P. nr. 230/14, dt. 08.06.2016

Sek.juridike
Drita J.F.i

Gjyqtari,
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.